



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 596/2 prot.

Tiranë, më 23. 06. 2021

### V E N D I M

#### Nr. 66, datë 23. 04. 2021

Mbështetur në nenin 32/1/c të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: *“Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”*, nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke marrë indicien nga informacioni i publikuar në media<sup>1</sup>, me urdhërin Nr. 44, datë 07. 04. 2021, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me gjuhën e përdorur në emisionin “OPEN” të datës 06.04.2021, në Top-Channel nga ana e analistit E. A. Me të njëjtin objekt ankese, pranë Komisionerit janë paraqitur edhe ankesat Nr. 63, datë 12.04.2021, nga Organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” dhe Nr. 66, datë 13.04.2021, nga një Grup Organizatash<sup>2</sup> në mbrojtje të të drejtave të komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në Nenin 33, pika 7/3 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *“Në rastet kur ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, drejtuar të njëjtit subjekt, kanë të njëjtin objekt, mund të bashkohen në një ankesë të vetme.”*, me Vendimin Nr. 63, datë 15.04.2021, vendosi bashkimin e trajtimit të këtyre ankesave me çështjen e nisur kryesisht me Nr. 44, datë 07.04.2021.

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të administruar, E. A., më datë 06.04.2021, ka qënë i ftuar në emisionin “OPEN”, në televizionin Top-Channel. Gjatë diskutimit lidhur me vaksinën kineze kundër Covid-19, Sinovac, është shprehur ndër të tjera se: *“...asnjeri nuk mban përgjegjësi. Pse? Se ne po veprojmë si shtet harixhinjsh, nuk ka shtet këtu. Nga makina e Edi Ramës qeveriset ky vend. A e dini ju që në Turqi është ngritur çështja kush e bëri marrëveshjen që u fut Keimen Ilaçi apo*

<sup>1</sup> [https://www.youtube.com/watch?v=RrIe\\_wgSRBE](https://www.youtube.com/watch?v=RrIe_wgSRBE)

<sup>2</sup> Organizatat: Community Reporters Albania, Roma Versitas Albania dhe Romano Kham

jo? A e dini ju që Keimen Ilaçi ka paguar një shumë, e cila është në dyshim, se është një firmë private dhe marrëveshja është bërë ndërmjet 2 ministrive të shëndetësisë? A e dini ju që ministri i shëndetësisë së Kinës ka shkuar në Turqi dhe ka dhënë garancitë për vaksinën e vet? Ndërsa në Shqipëri nuk kemi asnjë përfaqësues të prodhuesit të vaksinës që të thotë që kjo vaksinë ka efikasitet apo është e garantuar. Ky është një shtet harixhinjsh, ky është një vaksinim hajdutëshe...”.

Në këtë moment, E. A., i tërhiqet vëmendja nga të pranishmit për termin e përdorur dhe në përgjigje të tij ai sqaron se: “...Po jo, harixhinjtë nuk kanë organizim, nuk i shaj për racë, i shaj për mungesë organizimi..., do kërkoj ndjesë pastaj...”.

Në përfundim, ankuesit kanë kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit lidhur me shprehjet e përdorura dhe kërkimin e ndjesës publike nga ana e z. E. A.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>3</sup>, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a dhe c të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

---

<sup>3</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 596/1, datë 16.04.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga E. A., lidhur me pretendimet e palëve në proces.

E. A., më datë 19.04.2021, ka qënë i ftuar sërish në emisionin “OPEN” në televizionin Top-Channel. Gjatë diskutimit<sup>4</sup> lidhur me Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2021, M. K., i është drejtuar E. A. duke i shprehur se: “...ska gjë të keqe të kërkosh falje, se të kërkosh falje nuk është gjë e keqe edhe kur bën gabime. Edhe ti ke bërë gabim që ta dish, se edhe ti ke përdorur fjalor jo të përshtatshëm me qytetarët...i diferencon racat njerëzore. Edhe E. A. e ka bërë këtë gabim dhe ka shansin këtu të kërkoj falje publike...”. Në këtë moment nga ana e E. A. është ndërhyrë duke sqaruar se: “...Duhet ta kërkoj në fakt se kanë reaguar shoqatat...Në një nga emisionet televizive në OPEN, unë kam përdorur një terminologji të papërshtatshme për komunitetin rom dhe egjiptian, që në fakt nuk është në kulturën time, ju kërkoj falje, nuk jam racist, nuk përdor terma diskriminues në përgjithësi, ishte një zhargon...”, më pas ka vijuar me diskutimin në studio.

- Përsa më sipër, Komisioneri me anë të e-mailit, datë 22.04.2021, i dërgoi subjekteve ankues informacionin lidhur me faljen publike të kërkuar nga ana e E. A. dhe me link videon përkatëse, të emisionit OPEN. Gjithashtu, kërkoi nga ana e tyre informacion nëse bien dakord për realizimin dhe plotësimin e objektit të ankesave së paraqitura pranë KMD-së.

Me e-mail datë 22.04.2021, përfaqësuesit e Organizatave: Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Community Reporters Albania, Roma Versitas Albania dhe Rromano Kham, shprehën vlerësimin mbi bashkëpunimin me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe dakordësuan faktin që falja publike e bërë nga E. A. ka plotësuar qëllimin për të cilin kishin paraqitur ankesat e sipërcituara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes duke patur parasysh gjithmonë ndalimin e të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë, përçmojnë apo denigrojnë një komunitet apo përkatësi të caktuar. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta, synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste.

Në kuadër të ushtrimit të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe

<sup>4</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=90cfpfgoW6Q>, minuta 41:56

mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar edhe raste të tjera të gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për sa më lart, në kushtet kur subjekti ndaj të cilit ka nisur procedura hetimore ka reaguar në mënyrë shumë të shpejtë duke kërkuar ndjesë publike në emisionin OPEN në Top-Channel, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata është rregulluar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të gjuhës së përdorur ndaj anëtarëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese të E. A., lidhur me reagimin e menjëhershëm duke kërkuar ndjesë publike, për gjuhën e përdorur ndaj anëtarëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Neni 33, pika 9 e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”*.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se procedura administrative e nisur kryesisht bazuar në urdhërin Nr. 44, datë 07. 04. 2021, në lidhje me gjuhën e përdorur në emisionin “OPEN” të datës 06.04.2021, në Top-Channel nga ana e analistit E. A., bashkuar edhe me ankesat Nr. 63, datë 12.04.2021, nga Organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” dhe Nr. 66, datë 13.04.2021, nga një Grup Organizatash<sup>5</sup> në mbrojtje të të drejtave të komunitetit rom dhe atij egjiptian, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 9 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

---

<sup>5</sup> Organizatat: Community Reporters Albania, Roma Versitas Albania dhe Romano Kham

## **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të shqyrtimit të ankesave Nr. 63, datë 12.04.2021, të paraqitur nga Organizata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome”; Nr. 66, datë 13.04.2021, të paraqitur nga një Grup<sup>6</sup> Shoqatash në mbrojtje të të drejtave të komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe çështjes së nisur kryesisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me urdhërin Nr.44, datë 07.04.2021, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Raca)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>6</sup> Community Reporters Albania, Roma Versitas Albania dhe Romano Kham